



VENDIM

Nr. 15 Date 15.04.2015

PER MIRATIMIN E PROPOZIMIT PER FILLIMIN E PROÇEDURAVE PER SHPALLJEN “ZONE E MBROJTUR E BURIMEVE TE MENAXHUARA” TE EKOSISTEMIT TE GESHTENJAVE NE RRETHIN E TROPOJES

Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/1/b,13,54, ligjin Nr.8485 date 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative te Republikës se Shqipërisë”, ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008 “Për zonat e mbrojtura”, (i ndryshuar) nenet 4, 4/2, 11,13, VKM Nr.267, date 24.04.2003 “Për proçedurat e propozimit e dhe shpalljen e zonave te mbrojtura dhe buferike” , si dhe ne propozimin e bere nga Shoqata “Geshtenja e Tropojës” me shkresen Nr.149 Prot. date 03.04.2015,

VENDOSI:

1. T’i propozoje Ministrise se Mjedisit dhe Ministrise se Bujqesise, Zhvillimit Rural dhe Administrimit te Ujrave, fillimin e proçedurave per shpalljen “**Zone e Mbrojtur e Burimeve te Menaxhuara**” (Shkalla e IV e Mbrojtjes), te Ekosistemit Agro-Pyjor te Geshtenjes ne rrethin e Tropojes.

2. Kufijtë e ketij ekosistemi shtrihen si më poshtë vijon:

- a) **Geshtenja e Krasniqes:** Fillojne ne perroin e Gabrrajve ne pjesen jugperendimore dhe vazhdojne ne drejtimin lindor neper fshatin Geghysen, Gri, Rosuje, Bujan, Dojan, Markaj, Margegaj dhe Shoshan. Me krahun perendimor kufizohet me zonen e Ahut (Fagetum). Ne krahun verior, lumi Mullareka, ndersa ne krahun lindur – zonat e banuara.
- b) **Geshtenjat e Gashit:** Ne kufirin jugperendimor - lumi Mullareka, duke vazhduar ne fshatrat Begaj, Berbat, Kernaje, Hoxhaj dhe Myhejan. Ne perendim kufizohet me zonen e Ahut (Fagetum), ne veri lumi i Tropojes, ndersa ne krahun lindor zonat e banuara.
- c) **Geshtenjat e Shipshanit:** Fillojne ne krahun e djathte te lumit te Tropojes duke vazhduar me fshatrat Kasaj, Gegaj, dhe Kamenice dhe vazhdon jashte kufirit administrativ shteteror. Ne pjesen perendimore kufizohet me pyjet qe jane ne fondin pyjor shteteror. Ne krahun lindor me qendrat e banuara te fshatrave te permendur.
- d) **Geshtenjat ne Pac:** Ndodhen ne Demaliaj, ne nje siperfaqe prej 11 ha.
- e) **Geshtenjat ne Dushaj T`eper:** Gjenden ne fshatin Dushaj Eper ne nje siperfaqe prej 30 ha.
- f) **Geshtenjat e Lekbibaj:** Ndodhen te shperndara ne fshatrat Tetaj, Shengjergj, Curraj i Poshtem, Lekbibaj.

